



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORRUPCIJE
ANTI - CORRUPTION AGENCY

| | |
|------------------------|---|
| DATE/A: | 16.02.2015 |
| REFERENC-Ë: | AKK- DPK- DPKPP |
| PËR/ZA/TO: | z. Ismet HYSENI Udhëheqës i Prokurimit në Ministrinë e Shëndetësisë |
| CC: | z. Gani SHABANI Sekretar i Përgjithshëm në Ministrinë e Shëndetësisë |
| NGA/OD/FROM: | Hasan PRETENI Drejtor i Agjencisë kundër Korrupsionit |
| TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT: | Opinion lidhur me Tenderin me titull "Furnizim me Citostatik nga Lista Esenciale" |



Të nderuar,

Në mbështetje të nenit 5 paragrafi 1 nënparagrafi 1.12 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit dhe nenit 19 paragrafi 1 nënparagrafi 1.6 të Ligjit nr. 04/L-051 për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funkcionit Publik, lidhur me "Furnizim me Citostatik nga Lista Esenciale" me numër prokurimi: 206 15 001 111, Agjencia kundër Korrupsionit, ofron këtë:

OPINION

Në lidhje me Tenderin Publik "Furnizim me Citostatik nga Lista Esenciale" me numër prokurimi: 206 15 001 111, në mënyrë që të procedohet në pajtim me dispozitat përkatëse të Ligjit nr. 04-L/42 për Prokurimin Publik.

Arsyetimi

Ministria e Shëndetësisë si Autoritet Kontraktues me datë 03.02.2015 përmes zyrës së prokurimit ka paraqitur kërkesën zyrtare përmes postës elektronike në Agjencinë kundër Korrupsionit, përmes të cilës ka kërkuar që ndonjë përfaqësues nga Agjencia kundër Korrupsionit të jetë pjesë e Monitorimit lidhur me vlerësimin e tenderit me titull "Furnizim me Citostatik nga Lista Esenciale" me numër Prokurimi: 206 15 001 111.

Ky aktivitet i prokurimit më datë 08.01.2015 është shpallur në faqen elektronike të KRPP-së në procedurë të hapur, i cili është i ndarë në 11 lote.

Ku për **Lot 1** kemi furnizim me CAPECITABINE TBL 500mg, për **lot 2** kemi furnizim me ERYTHROPOETIN BETA shiringe e mbushur/sol 30000IU, për **lot 3** furnizim me FLUOURACIL sol për inj, për **lot 4** furnizim me IBANDRONATE konc. Per sol për inf, për **lot 5** furnizim me METHOTREXAT tbl., për **lot 6** furnizim me PEMETREXED plv për konc. Er sol., për **lot 7** furnizim me PEMETREXED plv per konc. Për sol, për **lot 8** furnizim me RITUXIMAB konc. Për **lot 9** furnizim me sol inf, RITUXIMAB konc, per sole inf, për **lot 10** furnizim me TEMOZOLAMIDE caps dhe për **lot 11** kemi TRASTUZUMAB konc. Për sol për inf.



Agjencia kundër Korrupsionit, pasi ka marr pjesë në cilësinë e monitoruesit në vlerësimin e tenderëve dhe ka shqyrtuar me kujdes të gjitha dokumentet e tenderit me titull "Furnizim me Citostatik nga Lista Esenciale" ka konstatuar të dhënat si në vijim:

Për këtë aktivitet të prokurimit dosjen e tenderit e kanë tërhequr gjithsej 17 Operator ekonomik ndërsa ofertat për këtë kontratë i kanë dorëzuar vetëm 9 OE.

Komisioni vlerësues pasi ka ekzaminuar dhe vlerësuar ofertat për **Lot 1** ka konstatuar se për këtë lot kanë ofertuar 6 Operatorë ekonomik ku 4 prej tyre që kanë tenderuar për këtë lot janë të përgjegjshëm, ndërsa 2 prej tyre nuk janë të përgjegjshëm pasi që nuk i përmbushin të gjitha kërkesat të cilat janë caktuar në njoftimin për kontratë dhe dosjen e tenderit.

Lidhur me **Lot 3** Komisioni vlerësues ka konstatuar se ka vetëm 1 ofertë e cila është e papërgjegjshme pasi që nuk i përmbushin të gjitha kërkesat të cilat janë caktuar në njoftimin për kontratë dhe dosjen e tenderit

Për **Lotët 2,5,8,9** dhe **11** komisioni vlerësues pasi ka ekzaminuar dhe vlerësuar ofertat ka konstatuar se ka vetëm nga një ofertues të cilët janë të përgjegjshëm.

Komisioni vlerësues pasi ka ekzaminuar dhe vlerësuar ofertat për **lot 4** ka konstatuar se për këtë lot kanë ofertuar 4 Operatorë ekonomik ku 2 prej tyre që kanë tenderuar për këtë lot janë të përgjegjshëm, ndërsa 2 prej tyre nuk janë të përgjegjshëm pasi që nuk i përmbushin të gjitha kërkesat të cilat janë caktuar në njoftimin për kontratë dhe dosjen e tenderit.

Edhe për **Lot 6** komisioni vlerësues pasi ka ekzaminuar dhe vlerësuar ofertat ka konstatuar se për këtë lot kanë ofertuar 2 Operatorë ekonomik ku 2 prej tyre që kanë tenderuar për këtë lot janë të përgjegjshëm dhe i përmbushin të gjitha kërkesat të cilat janë caktuar në njoftimin për kontratë dhe dosjen e tenderit.

Për **Lot 7** komisioni vlerësues ka konstatuar se ofertat e tyre i kanë dorëzuar dy Operatorë Ekonomik ku vetëm njëri nga këta është i përgjegjshëm dhe për **lot 10** komisioni vlerësues ka konstatuar se për këtë lot kanë ofertuar 6 Operatorë Ekonomik ku vetëm dy prej tyre janë të përgjegjshëm dhe i përmbushin të gjitha kërkesat të cilat janë caktuar në njoftimin për kontratë dhe dosjen e tenderit.

Agjencia kundër Korrupsionit pasi ka shqyrtuar dhe ekzaminuar me kujdes dokumentacionin e ofruar lidhur me këtë procedurë të prokurimit, dhe pas monitorimit që ka bërë në vlerësimin e këtij tenderit nuk ka gjetur prova të mjaftueshme me të cilat do të evidentohet ndonjë shkelje e dispozitave të LPP-së.

Në mbështetje të nenit 18 paragrafi 11 të Ligjit nr.03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, Agjencia mund të rihap rastin në çdo kohë nëse paraqiten rrethana të reja.



Me respekt !